



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 30.9.2021

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 30.9.2021, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 18.9.2019, është njoftuar vendimi nr. 286, datë 4.8.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë, të subjektit të rivlerësimit z. Genti Shala, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në datën 11.11.2020, në Institucionin e Komisionerëve Publikë është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi” (në vijim referuar si Rekomandimi i ONM-së), kundër vendimit nr. 286/2020, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vlerësim të Rekomandimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i ankimit, ka ushtruar ankim.

Për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik parashtron në vijim mungesën e hetimit në lidhje me elemente të reja, të pahetuara dhe të paarsyetuara më parë, gjatë vendimit të Komisionit, të cilat parashtrohen në përmbajtje dhe janë pjesë e Rekomandimit të ONM-së, në drejtim të këtyre

elementeve, përkatësisht: **(i)** një denoncimi të ardhur në adresë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në datën **.11.2020, në lidhje me pronësinë subjektit të rivlerësimit në një shoqëri ndërtuese dhe **(ii)** një kontrate huaje të vitit 2015, pasqyruar në regjistrin noterial, administruar nga Ministria e Drejtësisë, mbetet për t'iu paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit.

Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që, brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor për hetimin e këtyre dy çështjeve të reja dhe të pahetuara.

Për sa më sipër, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, në mënyrë të përmbledhur, parashtrojmë arsyetimin për rrethanat dhe faktet ligjore që kanë nevojë për hetim të mëtejshëm:

(i) Denoncimi mbi pronësinë në një shoqëri ndërtuese

1. Sikundër është parashtruar në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, në adresë të ONM-së, në datën **.11.2020, është dërguar një denoncim, ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit disponon 15% aksione të shoqërisë “*** ***” sh.p.k., me administrator z. ***.***.

2. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se duke marrë parasysh kohën kur është bërë denoncimi, në datën **.11.2020, si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ashtu edhe vëzhguesi ndërkombëtar i caktuar për çështjen, gjendeshin në pamundësi për të kryer hetimin në lidhje me pretendimin për disponimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të këtyre aksioneve, ndaj është i nevojshëm hetimi nga Kolegji në këtë drejtim. Ky denoncim duhet shqyrtuar gjatë procedurës gjyqësore në Kolegji, pasi pretendohet për pasuri të padeklaruar, të fshehur, të subjektit të rivlerësimit, që për shkak të momentit të paraqitjes së denoncimit nuk ka qenë i mundur të hetohet.

(ii) Akti noterial i datës **.5.2015, me palë subjektin e rivlerësimit

3. Referuar edhe përmbajtjes së Rekomandimit të ONM-së, nga aktet në dosje të Komisionit, ashtu sikurse është trajtuar dhe në shkaqet e ankimit, rezulton e administruar shkresa e Ministrisë së Drejtësisë me nr. *** prot., datë **.10.2019, me anë të së cilës është përcjellë lista e veprimeve (akteve) noteriale, duke filluar nga data 1.3.2013 deri më datën 21.10.2019, të kryer nga subjekti, z. Shala, dhe rrethi i familjarëve të tij. Në tabelën e këtyre veprimeve noteriale, në emër të subjektit të rivlerësimit, vërehet se subjekti, z. Shala, është palë në aktin noterial me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.5.2015, me përshkrimin e shkurtuar: “*Kont. hua*” dhe palë tjetër z. ***.***, për të cilën nuk është hetuar nga Komisioni.

4. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se duhet hetuar lidhur me përmbajtjen e këtij akti noterial, në funksion të natyrës së marrëdhënies së huas, pasi përmbajtja e kësaj kontrate huaje mund të ndikojë në aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për vitin përkatës të lidhjes së kësaj kontrate.

5. Në lidhje me denoncimet e ardhura pas depozitimit të ankimit, të përfshira dhe në shkresën nr. *** prot., datë **.9.2021, të Kolegjit, në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk parashtrihen elemente të mjaftueshme, të tilla që të referojnë nevojën e hetimit të mangësive në drejtim të kriterëve të profesionalizmit ose të figurës për subjektin e rivlerësimit.

(iii) Kërkimi i ankimit

6. Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik kërkon nga ky trup gjykues të çelë hetimin gjyqësor dhe se është i nevojshëm:

6.1 Administrimi i plotë i praktikës dokumentare për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor ***.***, duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.2 Administrimi i plotë i praktikës dokumentare për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., me numër ***.***, me përfaqësues ligjor ***.***, duke iu drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6.3 Administrimi i plotë i praktikës dokumentare për aktin noterial nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë **.5.2015, ku njëra palë është z. Genti Shala, duke iu drejtuar për administrimin e akteve noteres ***.***.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA